

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE UNIFORMES SE F.S.P.D-së

1-Bluzë me mëngë të gjata



Parametrat fizike:

Bluzat prodhohen me material 100% polyester fleece me mëngë të gjata për femra dhe për meshkuj janë njësoj në tekstil dhe ngjyrë **Blu Navy**.

Pjesët përbërëse të bluzës:

- Jaka gjysmë golf me zinxhir.
- Pjesa përpara
- Pjesa prapa (shpina)
- Dy mëngë të gjata

JAKA

Jaka duhet gjysme golf me zinxhir me gjatesi 20 cm dhe të ndërtohet me tekstil te njejte me materialin baze dhe duhet të ketë lartësi standarde 3 cm. Bashkimi me dy pjesët e bluzës duhet të bëhet me anë të një një filetoje me gjerësi rreth 1cm. Qepja e filetos tek jaka dhe tek bluza duhet të bëhet me një tegel linear dy gjilpërësh.

PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Pjesa para dhe ajo e pasme duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me tegel syzator 5 fijesh. Në linjën e shpatullave duhet qepur një fileto përforcuese për ruajtjen e formës së supeve. Tek pjesa e shpatullave të bluzës së meshkujve dhe të femrave, në brendësi, duhet të qepet një shtresë në formën e gjysme rrethit prej të njëjtit tekstil si bluza. Rrezja e rrethit duhet të jetë rreth 7-9 cm. Përmasa e saktë e rrethit duhet të variojë sipas masës së bluzës.

Në fund bluza duhet të mbyllet me një palosje me lartësi rreth 2 cm nga buza fundore. Palosja duhet të qepet me tegel linear dy gjilpërësh i përforcuar nga brenda me tegel syzator. Fundi i bluzës duhet të jetë i drejtë dhe duhet të ketë të njëjtën gjatësi si para ashtu edhe mbrapa.

MËNGËT

Mënga përbëhet nga një pjesë e vetme tekstili. Përmasat e mëngës duhet të ndryshojnë në varësi të masës së bluzës. Mënga duhet të bashkohet me trupin e bluzës me 2 tegela: 1 tegel qepës linear dhe 1 tegel syzator 5 gjilpërësh. Mënga duhet të mbyllet me një palosje me lartësi rreth 2 cm. Palosja duhet të jetë 2 cm dhe duhet të qepet me tegel syzator 5 fijesh (dy tegela linear dhe një syzator).

APLIKIMI I ELEMENTËVE VELCRO

Bluza **me mëngë të gjata** duhet të pajiset me 3 elementë Velcro femër:

1 copë për vendosjen e Logos së gjoksit.

1 copë për Logon e Mbiemrit, me përmasa 8.6 x 3 cm.

1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e Logos se F.S.P.D-se në mëngën e majtë.

Elementët Velcro në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlanguara. Elementi Velcro për vendosjen e shenjave në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës. Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonalë. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e frazulinës në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.

Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit. Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek Specifikimet Teknike. Tegelat e qepjes së bluzës duhet të jenë me hap 30 shpime në 5 cm. Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte. Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete. Të gjithë elementët e bluzës duhet të jenë simetrik. Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.) Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes. Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet. Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit. Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e bluzave është $\pm 2\%$. Elementëve Velcro nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë. Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:

EN ISO 14362-1:2017

EN ISO 14362-3:2017

EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Bluza **me mëngë të gjata** duhet të pajiset me 1 etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Kjo etiketë duhet të qepet në brendësi të bluzës, në anën e majtë, rreth 12 cm nga buza e poshtme e bluzës. Bluza duhet të paloset duke vendosur të dy mëngët në brendësi. Bluza e palosur duhet të vendoset në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen bluza të një numri dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë bluzash. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e bluzës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës

prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli **Bluzë me mëngë të gjata** do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Punonjësve të Sigurisë Portit Durrës*.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Cope: 420(katërqind e njëzet) cope.

2-Këpuçë Dimërore

Parametrat fizike

Lekure natyrale boks vici dhe astar meshini vici.

Kepucet prodhohen sipas modelit klasik me ngjyre të zeze, ku maja është në formë U-je. Pjesa e poshtme, sholla është me material gome me llokma të dhembzuara, me trashësi 7-8mm pa llokma dhe 15-16 mm me llokma. Pjesa e takes ka trashësi 25-27mm pa fjalpen dhe xhiron e gomes. Lekura e faqes, sipas të dhenave të mesiperme. Mbrapshtinat (veshet) në pjesën e sipërme të tyre kanë lekure të bute sheviro, brenda se ciles është vendosur një masë sfungjer, me qëllim që buzët e sipërme të jenë sa më të buta për një komoditet sa më të mirë. Veshja e brendshme me material GORE-TEX® me performancë të lartë 100% i papërshkueshëm nga uji dhe me ajrosje shumë të mirë dhe shtrroje lekure. Kepucet të jenë 6 vrima në secilin anë për kalimin e lidhesave. Lidhesat të jenë të zeza dhe të rrumbullakta, ose në formë kordoni me fije sintetike deri në 600mm. Në lekuren natyrale boks vici cil. I-re përfshihen lekuret e vicit që kanë sipërfaqe të shfrytëzueshme jo më pak se 96 % dhe lejohen të kenë 4 % të sipërfaqes me defekte ku 2 % në kupon. Lekuret duhet të jenë të shtrira mirë, të buta, të ngjeshura dhe kompakte. Nga ana e brendshme të jenë të pastruara, të zmeriluara dhe të barazuara. Ngjyrimi të jetë i njellojtë në të gjithë sipërfaqen dhe pa tonacione.

Lartësia e qafes së kepuces (duke ju referuar numrit 41) nga jashtë e matur mbi xhiron e gomes të jetë 130 +/- 10 mm. Realizimi i bashkimit të pjesës së poshtme me pjesën e sipërme të kepuces realizohet nëpërmjet teknologjisë me injeksion të drejtëpërdrejtë. Qepja e forcuar e shollës me pjesë të sipërme me tegel të fortë ngjyre të zeze. Pjesa e thembres me lekure të forcuar qepur me dopjo tegel. Pjesët anësore gjithashtu të qepura me dopjo tegel në të gjithë perimetrin. Në pjesën e sipërme të ketë një shirit kamoshi të butë për veshje komferte me lartësi 7-9mm. Në pjesën e pasme kjo pjesë kamoshi vjen e ngritur deri në 35mm.

bombe termoplastike me trashësi 1.4 +/- 0.1 mm.

forte termoplastike me trashësi 1.5 +/- 0.1 mm.

fiap gome e presuar me fortësi 85 +/- 3 grade shore (sipas STASH 2896–87) me trashësi 4–4.2 mm. xhiro gome e presuar me fiapen me pjerësi konike, trashësi 2.8-3 mm dhe gjeresi 17-19 mm. sholle gome e presuar TIP U me fortësi 75 +/- 3 grade shore (sipas STASH 2638 – 87) të presuar, nga poshtë duhet të jetë me llokma të dhembzuara, me trashësi 7-8 mm pa llokma, ndërsa me llokma trashësia duhet të jetë 13-14 mm. taka duhet të jetë e presuar së bashku me shollën me trashësi 25-26 mm.

Bashkimi i pjeses se sipërme te kepuces me pjesen e gomuar duhet te realizohet me injeksion.

pe sintetik me ngjyre te zeze per qepje e lekures 100 % sineteik dhe qendrueshmeri mbi 9 kG,per masurin Nm 40/3 dhe gjilperen Nm 30/3.

pe sintetik i thurur 1 mm per qepje 100 % PES dhe rezistence 38 kG (1000 g).

taban soleti lekure me trashesi 3-3.5 mm.lidhese te zeza te rrumbullakta thurje gershet deri ne 60 cm gjatesi.

- a. Të jenë kundra rrëshqitjes.
- b. Të krijojnë lehtësi në mbathjen e z bathjen e tyre.
- c. Lëkura të jetë “ëaterproof”, e cilësisë së parë dhe higjienike.
- d. Të jenë rezistente në shqitje të gomës.
- e. Të jenë rezistente ndaj plasjes së faqes dhe në këputje të saj.
- f. Pjesa e brendshme të mos lëshojë bojë.

Ngjyra e zezë.

Raporti midis gjatesise dhe gjeresise ne varesi te numrit te kepuceve te plotesoje kushtet e standartit shqiptar.Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Cope: 140 (njqind e dyzetë) Palë.



3-Çorape

Parametrat fizike

Çorape për uniformën e punës dimërore për meshkuj e femra të Forcës së Sigurisë Portit Durrës:

Modeli i çorapeve të jetë i njëjtë për të gjithë efektivin e Forcave të Sigurisë Portit Durrës.Përbërja të jetë 45% lesh, 45 % akrilik, 9 % poliamit,1 % llastik, të bëjë të mundur përthithjen e djersës gjatë përdorimit të mos pushëzohen.Filli i bazës dhe në ind të jetë i qëndrueshëm në këputje.Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës ndaj larjes, djersës, fërkimit, etj.Ngjyra e zezë. Masat që duhet te jene disponibile jane 37,38,39, 41, 43,45,49 sipas permasave te marra gjate matjeve.Për të vertetuar parametrat fizike do te analizohet

mostra e dorezuar. Corapet e burrave duhet te jene te certifikuara sipas standardit nderkombetar OKEOTEX Standard 100

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Cope: 420 (katerqind e njezet) Palë.



4-Rrip ushtarak i zi

Rrip mes, materiali tekstil i perforcuar me ngjyre te zezë. Gjatësia 145 (± 3 cm). Gjerësia 4.5 cm. Mberthimi i rripit realizohet me togëz ebaniti me ngjyre te zezë. Rripi në të gjithë gjatësinë e tij ka një shtresë perforcuese. Ai është i manovrueshëm në shtrëngimin apo lirimimin e gjatësisë së tij, duke pasur edhe një siguresë për funksionimin e saj.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Copë: 140 (njeqind e dyzetë) Copë.

5-Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa:

Specifikimi Teknik i artikullit “**Bluzë me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa**” për Forcat e Sigurisë FSPD paraqet kërkesat themelore teknike të domsdoshme. Të gjitha përcaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi. Treguesit fiziko – mekanik e kimik të lëndës së I-rë **trikotazh Blu Navy** si dhe të materialeve të tjera ndihmëse që do të përdoren për konfeksionimin e artikullit “**Bluzë me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa**” duhet të rezultojnë të jenë domosdoshmërisht në përputhje me Specifikimet Teknike të mëposhtme.

Bluza duhet te jete e certifikuar sipas standardit nderkombetar OKEOTEX Standard 100. **Materialet** që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “**Bluzë me mëngë të shkurtëra me jake me tre kopsa**” janë:

Lënda e I-rë trikotazh gri, cilësia e I-rë me këto të dhëna:

Ngjyra		Blu Navy
Përbërja		100% pambuk
Thurja		xhersi (e thjeshte) 1+1
Masa		170 +/- 5 gr/m2
Dendësia syth/10 cm		D vertikale 210 +/-8 syth D horizontale 155 +/-8 syth
Qendrueshmëria kG		Q v/h 18 - 3 kG
Numri Metrik		Nm 50/1
Trashësia e tekstili		0.5 +/- 0.1 mm
Qendrueshmëria e ngjyrës		Nota 4-5

Vlera e qendrueshmërisë së ngjyrës së lëndës **I**- re trikotazh Blu Navy duhet të jetë e qendrueshme dhe shumë e qendrueshme **Nota 4 - 5**. Ngjyra e mostrës e cila i nënshtrohet provës në qendrueshmëri ndaj fërkimit në të thatë dhe në të njomë, në larje solucioni sapuni dhe djersë nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituara në ofertë.

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit “**Bluzë me mëngë të shkurtëra me jake me tre kopsa**” janë:

Penj qepje Nm 80/2 100 % PES **Blu Navy**

Velkrofe femër me ngjyrë Blu Navy

Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa duhet të pajiset me 3 elementë Velcro femër:

1 copë për vendosjen e Logos së gjoksit.

1 copë për Logon e Mbiemrit , me përmasa 8.6 x 3 cm.

1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e Logos se F.S.P.D-se në mëngën e majtë.

PËRSHKRIM

Bluza me mëngë të shkurtra është model T-shirt me 3 kopsa. Përbëhet nga jaka , mëngët, shpina dhe gjoksi.


Jaka e bluzes është tip sport dhe duhet të jetë trikotazh methurje llastik 1+1.

Gjoksit lart në të dyja anët i qepet me tegela anësore dygjilperesh, materiali velkrof femer ngjyre të errët për vendosjen e logos së mbiemrit dhe logos së gjoksit .Gjoksit dhe shpinës i formohet në fund bordura me gjerësi **3 cm +/- 1 mm** duke palosur një herë trikotazhin në fund dhe duke i kaluar pastaj tegel dysh zbukurimi. Në qender të gjoksit në pjesën e sipërme është hapja e bluzes ku në anën e majte janë hapur tre vrima dhe në anën e djathtë janë vendosur 3 kopsa me ane të cilave realizohet mbyllja perkatese.

Mëngët në fund janë me bordurë me gjerësi **2-2.5 cm** dhe me material trikotazh methurje llastik 1+1. Në qëndër të mëngës së majtë me ulje **8-10 cm** nga maja e supit qepet me tegel dysh velkrof femër me ngjyrë të errët në të cilën do të fiksohet logo e krahut.

Në fillim bashkohet gjoksi me shpinën dhe pastaj fiksohen dhe mëngët . Mbyllja e bluzës fillon me bashkimin anësor të shpinës me gjokset dhe vazhdon me mbylljen e mengeve. Pastaj kryhet vendosja e jakës duke bërë kujdes që në përfundim jaka të jetë e shtrirë mirë duke mos krijuar vende të ngritura. Të gjithë bashkimet e pjeseve përbërëse të bluzës (tegelat) duhet të rrealizohen me makina të posaçme për qepjen e trikotazheve (makina qepje dygjilpërshe me grepa).

Spaletat:



Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në një anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza. Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu navy (njësoj si “Bluzë me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa”) me përmasa të njëjta. Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive. Perçina duhet të jetë në anën e “shigjetës”, distancë rreth 1.5 cm nga kulmi. Perçina duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i “**Bluzë me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa**”. Perçina duhet të jetë me diametër 17 mm, metalike,

ngjyrë blu navy. Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së **“Bluzë me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa ”**. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2-3 mm për çdo masë. Përmasat bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4.8 cm për masën më të vogël të së **“Bluzë me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa ”**dhe 18 x 4.8 cm për masën më të madhe të së **“Bluzë me mëngë të shkurtra me jake me tre kopsa ”**. Ne krahu e majte ne krahu e djathte te gjoksit vendosen velkrofet femer ne ngjyre Blu Navy per vendosjen e Logove ne gjoks dhe Logos se mbiemrit sipas modelit te percaktuar ne specifikimet per logot. Velkrof femer vendoset edhe ne mengjen e majte per vendosjen e logos ne krahe.

Tegelat e qepjes të bluzës duhet të jenë me hap **30** shpime në **5 cm**. Tegelat duhet të jenë të fortë, uniform, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rrëgullt dhe të drejtë. Tegelat duhet të jenë të fortë në mënyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forcës së duarve. Fortësia e tegelave të jetë mbi **12 kg**. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në fund. Peri që do të përdoret për qepje duhet të jetë i fortë dhe me ngjyrë të errët me **Nm 80/2, 100 % PES**. Në përfundim bluzës lart në shpine me anë të procesit të stampimit në formë harku i stampohen fjalet **“FSPD”**. Gërmat duhet të jenë të vendosura në mënyrë proporcionale dhe duhet kenë lartesi **8 cm** dhe gjerësi **1.5 cm**. Ngjyra e gërmave duhet të jetë fosforeshente me fortësi reflektimi **3 M** (normë e **CE-s**). Stampimi duhet të jetë i një cilësie shumë të lartë në mënyrë të tillë që të mos fshihet nën veprimin e larjes.

Bluza me mëngë të shkurtëra me jake me tre kopsa duhet të jetë simetrike në të gjithë elementët e saj.

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli “Bluzë me mëngë të shkurtëra” prodhohet dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas masave të gjokseve S, M, L, XL, XXL të cilat subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Çdo bluzë futet në qese celefoni dhe paketimi i tyre bëhet në kuti kartoni në sasi që pesha e tyre të mos shkaktojë deformim të kutisë. Mbi kuti vendoset etiketa ku të jetë shkruar qartë emri i firmës, numri i gjoksit, sasia dhe vula përkatëse.

Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

Cope: 420 (katerqind e njezet) Copë.

6-Këpuce verore



Parametrat fizike

Lekure natyrale boks vici dhe astar meshini vici.

Kepucet prodhohen sipas modelit klasik me ngjyre te zeze ,ku maja eshte ne forme U-je. Pjesa e poshtme,sholla eshte me material gome me llokma te dhembazuara ,me trashesi 7-8mm pa llokma dhe 15-16 mm me llokma. Pjesa e takes ka trashesi 25-27 mm pa fjapen dhe xhiron e gomes. Lekura e faqes ,sipas te dhenave te mesiperme. Mbrapshtinat(veshet) ne pjesen e siperme te tyre kane lekure te bute sheviro ,brenda se ciles eshte vendosur nje mase sfungjer,me qellim qe buzet e siperme te jene sa me te buta per nje komoditet sa me te mire.Veshja e brendshme me material GORE-TEX® me performance te larte 100% i papërshkueshëm nga uji dhe me ajrosje shume te mire dhe shtroje lekure.Kepucet te jene 6 vrima ne secilen ane per kalimin e lidhesave . Lidhesat te jene te zeza dhe te rumbullakta ,ose ne forme kordoni me fije sintetike deri ne 600mm.Ne lekuren natyrale boks vici cilesia I-re perfshihen lekuret e vicit qe kane siperfaqe te shfrytezueshme jo me pak se 96 % dhe lejohen te kene 4 % te siperfaqes me difekte ku 2 % ne kupon.Lekuret duhet te jene te shtrira mire,te buta,te ngjeshura dhe kompakte. Nga ana e brendeshme te jene te pastruara,te zmeriluara dhe te barazuara.Ngjyrimi te jete i njellojte ne te gjithë siperfaqen dhe pa tonacione. Lartesia e qafes se kepuces (duke ju referuar numrit 41) nga jashte e matur mbi xhiron e gomes te jete 100 +/- 10 mm.Realizimi i bashkimit te pjeses se poshte me pjesen e siperme te kepuces realizohet nepermjet teknologjise me injeksion te drejtperdrejte. Qepja e perforcuar e sholles me pjese e siperme me tegel te forte ngjyre te zeze. Pjesa e thembres me lekure te perforcuar qepur me dopjo tegel. Pjeset anesore gjithasthu te qepura me dopjo tegel ne te gjithë perimetrin. Ne pjesen e siperme Te kete nje shirit kamoshi te bute per veshje komfote me lartesi 7-9mm.Ne pjesen e pasme kjo pjese kamoshi vjen e ngritur deri ne 35mm. Bombe termoplastike me trashesi 1.4 +/- 0.1 mm.

forte termoplastike me trashesi 1.5 +/- 0.1 mm. Fiap gome e presuar me fortesi 85 +/- 3 grade shore (sipas STASH 2896–87) me trashesi 4–4.2 mm. Xhiro gome e presuar me fiapen me pjeresi konike,trashesi 2.8-3 mm dhe gjeresi 17-19 mm.Sholle gome e presuar TIP U me fortesi 75 +/- 3 grade shore (sipas STASH 2638 – 87) te presuar,nga poshte duhet te jete me llokma te dhembazuara, me trashesi 7-8 mm pa llokma, ndersa me llokma trashesia duhet te jete13-14 mm. Taka duhet te jete e presuar se bashku me shollen me trashesi 25-26 mm .Pe sintetik me ngjyre te zeze per qepje e lekures 100 % sineteik dhe qendrueshmeri mbi 9 kG,per masurin Nm 40/3 dhe gjilperen Nm 30/3. Pe sintetik i thurur 1 mm per qepje 100 % PES dhe rezistence 38 kG (1000 g) .Taban soleti lekure me trashesi 3-3.5 mm. Lidhese te zeza te rumbullakta thurje gershet deri ne 60 cm gjatesi.

Të jenë kundra rrëshqitjes.

Të krijojnë lehtësi në mbathjen e zbathjen e tyre.

Lëkura të jetë “waterproof”, e cilësisë së parë dhe higjienike.

Të jenë rezistente në shqitje të gomës.

Të jenë rezistente ndaj plasjes së faqes dhe në këputje të saj.

Pjesa e brendshme të mos lëshojë bojë.

Ngjyra e zezë.

Masat që duhet te jene disponibile jane 37,38,39, 41, 43,45,49 sipas permasave te marra gjate matjeve.Për të vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.Raporti midis gjatesise dhe gjeresisë ne varesi te numrit te kepuceve te plotesoje kushtet e standartit shqiptar.Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Kepuce verore 140(njeqind e dyzet)palë

7-Jelek fluoreshent me xhepa dhe zinxhir

Specifikimi Teknik i artikullit “Jelek fosforeshent” per FSPD paraqet kerkesat themelore teknike te domsdoshme .Te gjitha percaktimet teknike te ketij Specifikimi Teknik duhen te zbatohen detyrimisht sakte nga prodhuesi.Treguesit fiziko-mekanik e kimik te lendes se I-re si dhe te materialeve te tjera ndihmese qe do te perdoren per konfeksionimin e artikullit “Jelek fosforeshent” duhet te rezultojne te jene domosdosmerisht ne perputhje me Specifikimet Teknike te meposhtme.

Pershkrimi fizik:

Material fluoreshent dhe shirita reflektive te qepura. Ngjyre e verdhe.

Jelevu duhet te jete i paisur me dyshirita reflektues perimetrare horizontale me largesi 10.5-11 cm nga njera tjetra. Pa qepje anesore. 2 ane te perparme te bashkuara me zinxhir plastic ngjyre te zeze. Jake V. 2 xhepa perpara, nga 1 ne cdo ane ne forme te pjerret. Xhepat te kete nje filete reflektive ne rreze te bordures 25mm se xhepit.

Gjithashtu duhet te kete nje kapse rrumbullake plastike ne anen e djathte te gjoksit.

Ne pjesen e qafes te kete nje fileto te zi, qe zbret deri ne pjesen e fundit te zinxhirit me trashesi 8mm.

Ne pjesen fundore te kete gjithashtu 1 fileto te zi po ashtu me 8mm.

Pjesa fundore e kraheve te kete 1 shirit te zi me trashesi 8mm.

Te kete gjithashtu 2 shirita reflektues tek pjesa e supanjes me gjatesi 19cm.

Tek pjesa ku bashkohet supanja me gjoksin perpara dhe supanja me shpinen nga pas te kete nje fileto reflektuese.

Etiketa e jelevut duhet te permbaje: emrin dhe logon e prodhuesit dhe adresen e tij, modelin dhe kodin e produktit, standartin ISO qeofron, perberjen e materialit, masen, vitin e prodhimit, te dhenat ergonomike, instruksionet e perdorimit.

Parametrat teknike

Jelevu fosforeshent duhet te jete I certifikuar sipas Rregullores Europiane 2016/425 dhe te permbushe standartet e meposhtme: S.SH. EN ISO 13688:2013 dhe S.SH. EN ISO 20471:2013+A1:2016klasi I

100% polyester me peshe 130gr/m². Shirita fosforeshente CSR 1303-2. Masat S-XXXL

Cope e certifikuar OEKO TEX ku eshte testuar dhe ka kaluar me sukses

- Shkarkimin e nikelit
- Nivelin e pH – 6.6
- Nivelin e ngjyrujesve azoike (te cilet duhet e jene 0)

Stabiliteti i dimensioneve pas 25 larjeve me 40°C duhet te jete -3.6% per fijen e tendosur dhe -1.7% per fijen e thurur.

Percaktimi I vizibilitetit: Klasi 1. 0.51m² per materialin dhe 0.12m² per reflektuesin.

Te kete kaluar testet e kordinatave te kromaticitetit per materialet e reja, testet pas eksponimit me Xenon, zbehjen e ngjyrujes nga ferkimi, zbehjen e ngjyrujes nga djersitja, zbehja e ngjyrujes nga pastrimi kimik dhe zbehja e ngjyrujes pas larjes me 40 grade celcius.Rezistenca ndaj grisjes 1,12 * 10³ kPa.Shiriti reflektues fosforeshent duhet te kete kaluar testet e retrorefleksionit per: materialet e reja, pas gerryerjes, luhatjes se temperaturave, 25 larjeve ne 60°C , dhe ekspozimit ne shi.

OE ofertues duhet te paraqese certifikaten e konformitetit per produktin final të lëshuara ne emer te prodhuesit nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar qe verteton se artikulli i kerkuar eshte ne perputhje me standartet e kerkuara.

Ne pjesen e shpines shkruhet me material fosforeshent me germa kapitale fjala FSPD Lartesia e germave 7.1cm +/- 1mm, gjeresia 1.1cm +/- 1mm .Ne perpresen e majte, ne nivelin e gjoksit, shkruhet me material fosforeshent , me germa kapitale F.S.P.D.

Lartesia e germave 5 cm +/- 1mm, gjerësia 5mm +/- 0.1mm .

Artikulli “Jelek fosforeshent” prodhohet dhe porositet nga perdoruesi ne sasite perkatese sipas masave te gjokseve S, M, L, XL, XXL te cilat subjekti prodhues eshte i detyruar ta respektoje saktesisht.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi

Cdo jelek futet ne qese telefoni dhe paketimi i tyre behet ne kuti kartoni ne sasi qe pesha e tyre te mos shkaktoje deformim te kutise. Mbi kuti vendoset etiketa ku te jete shkruar qarte emri i firmes,numri,sasia dhe vula perkatese.

Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik. Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Jelek fluoreshent me xhepa dhe zinxhir 140(njeqind e dyzet)cope.

8-Kostum Sportiv.

Specifikimi teknik i artikullit, “Kostum sportiv” per punonjesit e punonjese e Forcës së Sigurisë së Portit Durrës paraqet kerkesat themelore teknike te domosdoshme per prodhimin ne linje industriale mbi bazen e proceseve teknologjike artikullit “kostum sportiv“ Ne kete specifikim teknik percaktohen gjithashtu dhe kerkesat cilesore te ketij artikulli.

Te gjitha percaktimet teknike te ketij specifikimi teknik duhen te zbatohen detyrimisht sakte nga prodhuesi.

Per procedure vleresimi dhe miratimi nga perdoruesi, kontraktuesi eshte i detyruar te paraqesi si oferte teknike te realizuar sipas kerkesave te ketij specifikimi teknik : - 1 (nje) komplet kostumi sportiv (bluze,tuta) me nr gjoksi 50 .

Kostumet e sportit (Bluze dhe Tuta me minge te gjata),te jene me permbajtje poliester 60 %, dhe pambuk 40 %.

Ne pjesen e brendshme te bluzes dhe tutave te kete te qepur nje rrjete ne forme astari e cila sherben per thithjen e djerses.

Ngjyrat te jene te ndryshme ku te mbizoteroje ngjyra kuqe me te zeze si dhe kombinacione te tjera te mundeshme. Permasat te jene: S , M , L , XL ,XXL,XXXL .

Amballazhimi ne kuti kartoni me etiketa perkatese te firmes furnizuese.

Kolaudimi marrja në dorëzim.

Pranimi i te gjithë sasise te artikullit “Kostum sportiv” te percaktuar ne kontrate dhe te dorezuar ne magazinën e porositës do te behet vetem ne baze te rezultateve qe do te merren gjate procesit te Kolaudimit per te gjithë sasine e produktit te gatshem te dorezuar ne magazine. Teknikisht kolaudimi do te behet mbi bazen e kryerjes direkt te matjeve dhe provave fizike te mostrave perfaqesuese te sasise se mallit te dorezuar dhe krahasimin e te gjitha ketyre rezultateve me kerkesat dhe te dhenat teknike te ketij specifikimi teknik.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij specifikimi teknik.

Kostume sportive dimëror(një bluze me zinxhir +tuta) 140(njeqind e dyzet)pale

9-Atlete sporti.

Ky specifikim teknik paraqet kerkesat themelore teknike te domosdoshme per artikullit “ Atlete sporti“ Ne kete specifikim teknik percaktohen gjithashtu dhe kerkesat cilesore te ketij artikulli.

Te gjitha percaktimet teknike te ketij specifikimi teknik duhen te zbatohen detyrimisht sakte nga furnizuesi.

Artikulli “atlete sportive” te jete i perbere nga keto elemente:

-Pjesa e sipërme te jete material lekure e imituar e bute dhe te padeptueshem nga uji.

-Pjesa e poshtme ose sholli, te jete material i gomuar me format e takave ne menyre qe te siguroje mbeshetje te mire te atleteve ne toke dhe te mos rreshqase ne siperfaqet e sheshta apo te lemuara.

Te jete i ngjitur me ngjites me dy komponente ne temperaturen 60-70 grade me pjesen e sipërme (surprinen) dhe te siguroje qendrueshmeri te larte ne shqitje. Astari i brendshem dhe tabani te jete material i bute dhe te siguroje depurtueshmerine e djerses.

Lidheset te jene sintetike me gjatesi qe varen nga forma dhe menyra e ndertimit te struktures se atletes Ngjyrat te jene te ndryshme ku te mbizoteroje ngjyrat e erta si dhe kombinacione te tjera te mundeshme. Numrat e atleteve te jene 39 deri 44.

Sasia sipas numerave do të behet mbi bazen e kerkesave teForcës se Sigurisë së Portit Durrës me lidhjen e kontrates me prodhuesin (fituesin).

Amballazhimi ne qese plasmasi te cilat futen ne kuti kartoni me etiketa perkatese te firmes furnizuese. Ofertuesit duhet te paraqesin ne tender detyrimisht mostren e atleteve te sportit .

Mungesa e mostres eshte kusht skualifikues

KOLAUDIMI MARRJA NE DORËZIM

Pranimi i te gjithë sasise te artikullit “Atlete sporti” te percaktuar ne kontrate dhe te dorezuar ne magazinën e porositesit do te behet vetem ne baze te rezultateve qe do te merren gjate procesit te kolaudimit per te gjithë sasine e produktit te gatshem te dorezuar ne magazine.Teknikisht kolaudimi do te behet mbi bazen e kryerjes direkt te matjeve dhe provave fizike, te sasise se mallit te dorezuar, dhe krahasimin e te gjitha ketyre rezultateve me kerkesat dhe te dhenat teknike te ketij specifikimi teknik.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

Atlete sportive dimëror 140(njeqind e dyzet) pale

10- Shenja dalluese

-Gradat sipas funksionit në spaleta për punonjësit e Forces se Sigurise .

Gradat **sipas funksionit në spaleta për punonjësit e Forces se Sigurise** për të gjithë punonjësit e **Forces se Sigurise** duhet të vendosen lart në të dyja supet të çdo artikulli të uniformës që kanë spaleta për vendosjen e tyre. Gradat dhe elementët saj dekorativ duhet të prodhohen me materialet dhe format e kërkuara nga **Forca e Sigurise** . Ato duhet të prodhohen në bazë të pamjes së jashtme, modelit, përmasave dhe ngjyrave të përcaktuara në këtë dokument.



Nën Agjent



Agjent



Agjent i I-rë



Inspektor



Kryeinspektor



Kapiten / Zv/ Shef



Kapiten i III-të / Shef



Kapiten i II-të / Zv/Drejtor



Kapiten i I-rë / Drejtor

Te dhenat teknike per prodhimin **Gradave sipas funksionit në spaleta për punonjësit e Forces se Sigurise .**

MATERIALET :

Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit **Grada sipas funksionit në spaleta për punonjësit e Forces se Sigurise** ndahen në:

a. Materiali i bazamentit

b. Elementët dekorativë në PVC (tora) (polivinil kloruri) dhe të qëndisur

a. Materiali i bazamentit duhet të jetë tekstil ngjyrë zezë, i cilësisë së I-rë, i përforcuar nga brenda me silikon i cili bën bashkimin me një shtresë polivinil kloruri (PVC) që të rezistojë në kohë, të ketë fleksibilitet dhe plasticitet.

Materiali i përdorur duhet të jetë rezistent ndaj efektit të agjentëve atmosferikë në mënyrë që të mos i ndryshojë ngjyra me kalimin e kohës. Materiali i bazamentit duhet të ketë këto të dhëna teknike: Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5.

Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: jo më pak se – nota 6: shumë e mirë. S i provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohe për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e zezë nuk transferohet tek tekstili i bardhë. Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse): – papastërtitë me origjinë bimore, – njolla vaji ose boje, – tonalitete të ngjyrës, – oksidime, – rrudhosje, – mungesë të fijeve të indit dhe të bazës, – trashim të fijeve të indit dhe të bazës, – vrima në sipërfaqe, – dhe çdo parregullsi tjetër që çënon anën funksionale dhe estetike të uniformës. Të gjithë këto elementë dhe aksesore, mund të zëvendesohen me material të ngjashëm, vetëm nëse kanë karakteristika të barabarta dhe/ose të përmirësuara, që t'i përgjigjen plotësisht specifikave të kërkuara për prodhimin e produktit. Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

Ngjyra zezë për bazën e gradës.

Ngjyra e artë për elementët plastikë, elementët me qëndisje dhe tekstilin prej mëndafshi.

Ngjyrat e paraqitura në këtë specifikim teknik janë ngjyra që prodhuesi duhet t'i ketë si referencë. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Përmasat e gradave sipas funksionit në spaleta për punonjësit e forces se sigurise .

Bazamenti i gradës ka pamje të sipërme drejtkendore dhe duhet të ketë këto përmasa: gjatësia e gradës duhet të jetë 90 mm ndërsa gjerësia e trapezit – 60 mm baza e madhe dhe baza e vogël; Për rangjet Kapiten i II dhe Kapiten i I, gjatësia e gradës duhet të jetë 105 mm ndërsa gjerësia e trapezit - 60 mm baza e madhe dhe 52 mm baza e vogël. Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

SASIA E PRODHIMIT

Artikulli **gradave sipas funksionit në spaleta për punonjësit e forces se sigurise** duhet të prodhohen në çifte, sipas sasisë së specifikuar nga porositi. Prodhuesi ka për detyrë që të parashikojë prodhimin e kësaj sasive saktësisht sipas specifikimeve të porositis bazuar ne organogramen e **Forces se Sigurise**.


Ndërtimi teknik i bazamentit të gradës sipas funksionit në spaleta për punonjësit e forces se sigurise

Bazamenti i gradës duhet të ketë **strukturë tubolare**. Në anën e pasme, tekstili duhet të jetë i përforcuar në të gjithë sipërfaqen e tij me shtresë polivinil kloruri (PVC). Ngjitja duhet bërë me anë të nxehtësisë. Shtresa përforcuese duhet të jetë e pashqitshme. Mbyllja e gradës duhet të bëhet nëpërmjet termofiksimit. Puthitja e dy anëve të tekstilit duhet të ketë gjerësi 1cm. Ngjitja duhet t'i rezistojë kohës dhe përdorimit të shpeshtë. Më pas aplikohen me termofiksimit ose me qëndisje elementët e tjerë dekorativ të gradës në përputhje me rangun e grades.


PUNIMI I ELEMENTËVE TË GRADAVE

Elementët e gradës duhet të jenë të punuara me qëndisje me fije të arta tekstili. Ato duhet të kenë sipërfaqe me shkëlqim, të punuar artistikisht me relief dekorativ. Elementët e lyer me spërkatje nuk do të pranohen. Elementët në gradë janë prodhuar në formatin 3D. Vendosja e elementëve duhet të bëhet me qepje .

KOMPOZIMI I GRADAVE TE SPALETAVE SIPAS FUNKSIONIT



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë tubolare e pershtatshme për tu futur në spaletat e veshjeve, me dimensione 60 mm x 90 mm x 60 mm. Shirit i artë i punuar me qëndisje, fije të artë 7mm në formë < ku mesi i shiritit të perkojë me aksin qendror të Gradës. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementë dekorativë Torra e Durrësit, me spirance, si foto mëposhtëme:



distanca e logos (Torra me spirance të jete në propocion me graden).

Shënim: Kompozimi gradave sipas funksionit në spaleta për punonjësit e forces Sigurise do të ndjehet te njejtën llogjike për të gjithë gradat sipas funksioneve me të gjithë elementet e paraqitur

ne fotot më sipër dhe ne momentin e lidhjes së kontratës do të përcaktohet sasia për çdo lloj grade sipas funksionit të Forces së Sigurisë.

Për gradat e tjera bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë tubolare e përshtatshme për tu futurë në spaletat e veshjeve, me dimensione 60 mm x 90 mm x 60 mm. Shiriti i artë i punuar me qendrisje 7 mm i drejte dhe 13 mm do të dakortohet sipas numrit të gradave në vartësi të organogramës së Forces së Sigurisë në momentin e lidhjes së kontratës me OE . Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elemente dekorative me qendrisje me fije të artë si foto:

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Gradat sipas funksionit në spaleta për punonjësit e Forces së Sigurisë - 140(njëqind e dyzet)copë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE ARTIKUJVE VESHMBATHJE DIVIZIONI OPERACIONAL

1-VESHJE SPECIALE KUNDER ZJARRIT PËR PMNZSH

Specifikimet Teknike të artikujve të mëposhtëm janë hartuar në përputhje me V.K.M-në Nr.1153 dt.24.12.2020 “PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS, SHENJAVE DALLUESE PËRKATËSE, FLAMURIT DHE STEMËS SË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN” dhe për sasinë e artikujve sipas tabelës së Miratuar në planin e blerjeve të A.P.D për vitin 2023 ,aneksi shpenzimeve për Veshmbathje.

Këto *Specifikime Teknike* parashtrojnë në mënyrë të detajuar kërkesat themelore teknike të domosdoshme për ndërtimin e prototipit dhe prodhimin e artikullit.*Specifikimet Teknike* përcaktojnë gjithashtu edhe kërkesat teknike të aksesorëve që duhet të shoqërojnë artikullin.

UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)

Khaketa dhe pantallonat për mbrojtje nga zjarri, duhet të jenë të punuara dhe të certifikuara në përputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.

Përveç kësaj, khaketa për mbrojtje nga zjarri duhet të plotësojë edhe standardin EN 469:2005, shtojca B.

Prodhuesit ose subjekti që i trajton këto produkte është i detyruar të paraqesë certifikatat e vlefshme të produktit.

